



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**

**PROCUREMENT REVIEW BODY**

*208/21*  
*23.03.2021*

PRISHTINE - PRISTINA

**PSH.nr.208/21**

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, panelist individual Blerim Dina - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “Loshi-Design” – Gurakoc, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik “Adi te Construction” shpk, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Fasadimi i ndërtesave te banimit ne bashkëpronësi te paraluftës”, me nr te prok: 633-20-5698-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK ISTOG”, më datë: 22.03.2021 , mori këtë:

## **V E N D I M**

I. **APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Loshi-Design” – Gurakoc, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Fasadimi i ndërtesave te banimit ne bashkëpronësi te paraluftës”, me nr te prok: 633-20-5698-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK ISTOG”.

II. **VËRTETOHET**, njoftimi për dhënie te kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Fasadimi i ndërtesave te banimit ne bashkëpronësi te paraluftës”, me nr te prok: 633-20-5698-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK ISTOG”.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik “Loshi-Design” – Gurakoc, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues NNT “Loshi-Design” – Gurakoc, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 05.03.2021 me nr. 208/21, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Fasadimi i ndërtesave të banimit në bashkëpronësi të paraluftës”, me nr të prok: 633-20-5698-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK ISTOG”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 59, 60, 64 dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 08.03.2021, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 15.03.2021, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:

Pas shqyrtimit në detaje të lëndës së tenderit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe duke u bazuar në dokumentacionin në dispozicion, eksperti shqyrtues jep këtë mendim si në vijim:

Duhet sqaruar që ankesa e OE ankues shqyrtohet për herën e dytë pasi që Eksperti Shqyrtues vecse ka trajtuar një herë lëndën me të njejtin numër të prokurimit. Raporti paraprak me numër rendor 930/20 përmban disa nga pretendimet ankimore të adresuara edhe në ankesën ekzistuese.

Sa i përket pretendimit të OE ankues ku thuhet që OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kërkesën e FDT-së përkatësisht kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale neni 9.1 & 9.2 tek kapaciteti teknik dhe profesional ku si kërkesë ka qenë “Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka ose mund të angazhoj staf teknik të mjaftueshëm dhe atë min. 10 punëtorë” ndërsa si dëshmi dokumentare duhet të ketë “Listën e punëtorëve nga ATK, së paku për 3 muajt e fundit para publikimit të njoftimit për kontratë; për stafin e angazhuar për këtë projekt i cili nuk është në marrëdhënie pune me OE ofertues, si dëshmi të paraqiten lista e

punetoreve dhe kontratat për projektin në fjalë” pasi që OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar një listë të pagave nga ATK që dyshohet që ka pasur ndërhyrje nga ky i fundit, Eksperti Shqyrtues vlerëson që një çështje e tillë është vecse e gjykuar (res judicata) në raportin paraprak.

Sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues ku thuhet që OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se menaxherin e projektit të cilin e ka prezantuar nuk plotëson kërkesën e FDT-së e cila ka qenë “Menaxheri i projektit të jetë Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisëKonstruktiv, me së paku 3 vite përvojë punë pas diplomimit, të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku tri (3) projekte te natyres se njejte (fasadim te objekteve)” me dëshmi dokumentare të kërkuar “per menaxher të projektit; CV, diploma e skanuar nga origjinali, vendimi per caktim te menaxherit, kontrata e punes ose parakontrata per projektin ne fjale dhe letër referencat për së paku 3 projekte të përfunduara”, Eksperti Shqyrtues vlerëson që në kontratën e dorëzuar nga OE i rekomanduar, kontratë kjo e lidhur ndërmjet punëdhënësit “Adi TE Construction” dhe punëmarrësit “Nystret Kastrati” përcaktohet periudha e angazhimit në nenin 6 të saj, ku thuhet që “Punëmarrësi, në punë dhe detyra specifike të përcaktuara sipas nenit 3 të kësaj Kontrate, do të angazhohet prej 04.04.2020 deri me 04.05.2021, përkatësisht 365 ditë”, periudhë kjo e mbulueshmërisë së këtij aktiviteti. Andaj, një pretendim i tillë ankimor është i pabazuar.

Sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues ku thuhet se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka prezantuar asnjë kontratë referencë konform kërkesave të FDT-së duke marrë parasysh faktin që një kërkesë e tillë ka qenë “Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së njëjtë (fasadim te objekteve) në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë.”, Eksperti Shqyrtues pas shqyrtimit të listës së kontratave dhe dëshmive dokumentare të dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontratë, jep këtë përgjigje:

Për faktin që kërkesa e shënuar nga AK në FDT dhe Njoftim për Kontratë ka qenë e specifikuar vetëm në kontrata të fasadim të objekteve, Eksperti Shqyrtues ka vlerësuar herën e parë që konform dispozitave ligjore në fuqi të shënuara edhe në RRUOPP, mbetet nën diskrecion të Autoritetit Kontraktues që të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të LPP-së.

Pas përgjigjes ndaj kërkesës për rishqyrtim të AK-së ku përmendet arsyetimi “*Te përshkrimi teknik-oferta financiare te Kontratat e prezentuara nga OE përmbajnë pozicione me fasadim*” mirëpo nuk përcaktohen pozicionet dhe kontratat në fjalë, Eksperti Shqyrtues i ka dërguar email sqaruese AK-së ku ka kërkuar detaje për kontratat mbi të cilat është konstatuar një gjë e tillë (shih faktin me nr.: 8). Autoriteti Kontraktues ka dërguar email me dokumente mbështetëse, ku janë të paraqitura pozicione brenda kontratave të dërguara si referencë të cilat përkojnë me fushveprimin ekzistues të aktivitetit të prokurimit. Si rezultat i sqarimeve shtesë konform

dispozitave ligjore në fuqi, Autoriteti Kontraktues ka ri-vlerësuar tenderin konform nenit 59 të Ekzaminimit, Vlerësimit dhe Krahësimit të Tenderëve.

Duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, kronologjinë e rastit në fjalë, dokumentet mbështetëse dhe natyrën e pretendimeve, Eksperti shqyrtues e sheh ankesën e operatorit ekonomik ankues si të pabazuar, duke sugjeruar kështu që njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "FASADIMI I NDERTESAVE TE BANIMIT NE BASHKPRONESI TE PARALUFOTES" me nr. të prokurimit: "633-20-5698-5-2-1", *aktivitet ky i iniciuar nga AK: Komuna e Istogut*, të mbetet në fuqi dhe të vërtetohet vendimi i AK-së. Një sugjerim i tillë vjen si rezultat i konstatimeve të pretendimeve dhe dokumenteve mbështetëse.

Mendimi i ekspertit shqyrtues : Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues duhet të jetë: e pabazuar dhe të vërtetohet vendimi i AK-së.

Autoriteti kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës 17.03.2021, ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik përmes parashtresës me shkrim të datës 16.03.2021, ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues

Kompania jone NUK PAJTOHET me mendimin e ekspertit shqyrtues te lendes 208/21. Pika e pare e mos pajtimit te eksperiti shqyrtues (shi ankimimin tone,përgjigjen e ekspertit shqyrtues,Kontratën e z.Nysret Kastrati) ANKIMIMI JONE

Gjithashtu kontrata e menaxherit te projektit Nysret Kastrati ti shiqohet ne detaje nga eksperti shqyrtues dhe ta vërteton filliinin e tijë ne pune data e nënshkrimit te kontrates se z.Nysret Kastrati është 01.04.2020 dhe është e cekur per këtë projektë.kurse data e B05 Njoftimi për kontratë e kti projekti ne Eprokuriin eshte 24.09.2020 dhe data e mbyijes ka qene 09.10.2020 gjithashtu ne listen e pagave te ATK-së te prezantuar emri ti nuk figuron te verfetohet ne detaje kontrata dhe ne list te ATK-së.

Pergjigja e ekspertit shqyrtues

Sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues ku thuhet që OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se menaxherin e projektit të cilin e ka prezantuar nuk plotëson kërkesën e FDT-së e cila ka qenë "Menaxheri i projektit të jetë inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisëKonstruktiv, me së paku 3 vite përvojë punë pas diplomimit, të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku tri (3) projekte te natyres se

njejte (fasadim te objekteve)” me dëshmi dokumentare të kërkuar “per menaxher të projektit; CV, diploma e skanuar nga origjinali, vendimi per caktim te menaxherit, kontrata e punes ose parakontrata per projektin ne fjale dhe letër referencat për së paku 3 projekte të përfunduara”, Eksperti Shqyrtues vlerëson që në kontratën e dorëzuar nga OE i rekomanduar, kontratë kjo e lidhur ndërmjet punëdhënësit "Adi TE Construction" dhe punëmarrësit “Nystret Kastrati” përcaktohet periudha e angazhimit në nenin 6 të saj, ku thuhet që “Punëmarrësi, në punë dhe detyra specifike të përcaktuara sipas nenit 3 të kësaj Kontrate, do të angazhohet prej 04.04.2020 deri me 04.05.2021, përkatësisht 365 ditë”, periudhë kjo e mbulueshmërisë së këtij aktiviteti. Andaj, një pretendim i tillë ankimor është i pabazuar.

Shih kontraten

## KONTRATË PUNE PËR PUNË DHE DETYRA SPECIFIKE

### Neni 1

Me këtë Kontratë:

1. Punëdhënësi: **ADI-TE-CONSTRUKSION**, Carallukë 31010 Banje e Pejës me numër të Biznesit **811224592**

të cilin e përfaqëson: Astrit Sylaj

dhe

2. Punëmarrësi: **Nysret Kastrati** me nr.personal:1009707279, ing. I Nilertimtaris dhe Konstruktiv, vendanim ne **Peje**.

përcaktojnë të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë për krijimin e marrëdhënieve kontraktuale të punës.

### Neni 2

Punëdhënësi i ofron, ndërsa punëmarrësi pranon të lidhë kontratë pune për një detyrë specifike e cila nuk mund të jetë më e gjatë se njëqindënjëzetë (120) ditë brenda një viti kalendarik.

### Neni 3

Punët dhe detyrat specifike të cilat duhet t'i kryejë punëmarrësi për punëdhënësin, konsistojnë në: **Mbikqyrjen e punëve, Menaxher i Projekteve, Ndertimtari.**

**FASADIMI 1 NDERTESAVE TE BANIMIT NE BASHKPRONESI TE PARALUFITES**

### Neni 4

Punëmarrësi është i detyruar të fillojë punën më: 04.04.2020

#### **Neni 5**

Nëse punëmarrësi nuk e fillon punën ditën e caktuar, sipas marrëveshjes në këtë Kontratë, pa e paralajmëruar punëdhënësin për arsyet e mos fillimit të punës, do të konsiderohet se me vullnetin e vet, e ka shkëputur këtë kontratë në mënyrë të njëanshme.

#### **Neni 6**

Punëmarrësi, në punë dhe detyra specifike të përcaktuara sipas nenit 3 të kësaj Kontrate, do të angazhohet prej: 04.04.2020, deri më: 04.05.2021, përkatësisht 365 ditë.

#### **Neni 7**

Orari i punës është 40 orë pune në javë. Nëse Punëdhënësi dhe Punëmarrësi nuk merren vesh ndryshe. Pushimi gjatë ditës së punës, caktohet sipas marrëveshjes në mes të punëdhënësit dhe të punëmarrësit, varësisht nga koha e kaluar në punë.

Punëdhënësi mund ta ndryshojë orarin gjatë ditës, sipas nevojës së paraqitur në procesin e punës.

#### **Neni 8**

Paga bazë mujore (çmimi i punës), për angazhim të Punëmarrësit sipas nenit 3 të kësaj Kontrate në punët dhe detyrat specifike, është në lartësinë e shumës prej: 400 € (dhe me shkronja: katërqind) euro.

Pagesa bëhet çdo muaj, për muajin paraprak, përmes xhironlogarisë së Punëmarrësit, te banka e autorizuar, apo në afatë më të shkurtra kohore, sipas marrëveshjes së palëve kontraktuese.

#### **Neni 9**

Punëmarrësit, për angazhim në punët dhe detyrat specifike të përcaktuara sipas nenit 3 të kësaj Kontrate, nuk i takon e drejta në pushim vjetor dhe të drejtat e tjera të përcaktuara në Kontratën Kolektive dhe Kontraten e Punës.

#### **Neni 10**

**Punëdhënësi obligohet që gjatë kryerjes së detyrave të punës, të sigurojë për Punëmarrësin mjetet dhe masat e mbrojtjes në punë, sipas dispozitave të përcaktuara me Ligj, Kontratë Kolektive dhe me akte të tjera nënligjore.**

#### **Neni 11**

Punëmarrësi është i detyruar sipas dispozitave ligjore, t'iu përmbahet masave të caktuara të mbrojtjes në punë.

#### **Neni 12**

Punëmarrësi pajtohet që gjatë gjithë procesit të punës, mund të caktohet të punojë edhe në ndonjë detyrë tjetër të punës, sipas nevojave të Punëdhënësit dhe kushteve të përcaktuara me Ligj, Kontratë Kolektive apo me Kontratë të Punës.

#### **Neni 13**

Punëdhënësi dhe Punëmarrësi me vullnet të dyanshëm i pranojnë të gjitha të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e caktuara me Ligj, në Kontratë Kolektive dhe me këtë Kontratë.

#### Neni 14

Palët kontraktuese mund të arrijnë marrëveshje edhe për të drejta dhe detyrime të veçanta, të cilat nuk janë në kundërshtim me dispozitat e akteve ligjore dhe nënligjore të aplikueshme.

#### Neni 15

Për mosmarrëveshjet eventuale, lidhur me zbatimin e kësaj Kontrate Pune, palët kontraktuese e pranojnë kompetencën e Gjykatës Komunale në: ISTOG

#### Neni 16

Pas njoftimit me përmbajtjen e kontratës, kjo Kontratë u nënshkrua nga palët kontraktuese, më datën: 01.04.2020, në: Carallukë, kopje autentike, nga të cilat, secilës palë i mbeten nga dy kopje.

Punëmarrësi

Nystret Kastrati



Punëdhënësi

Astrit Sylaj



Official stamp of ADI TE CONSTRUCTION, Carallukë, Istog, with identification number 011224592.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 22.03.2021, pa praninë e palëve konform nenit 26.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverballi mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, ku thuhet që OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kërkesën e FDT-së përkatësisht kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale neni 9.1 & 9.2 tek kapaciteti teknik dhe profesional, ku si kërkesë ka qenë: “Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka ose mund të angazhoj staf teknik të mjaftueshëm dhe atë min. 10 punëtorë”, ndërsa si dëshmi dokumentare duhet të ketë “Listën e punëtorëve nga ATK, së paku për 3 muajt e fundit para publikimit të njoftimit për kontratë; për stafin e angazhuar për këtë projekt i cili nuk është në marrëdhënie pune me OE ofertues, si dëshmi të paraqiten lista e punetoreve dhe kontratat për projektin në fjalë”. Pasi që OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar një listë të

pagave nga ATK që dyshohet që ka pasur ndërhyrje nga ky i fundit, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson që një çështje e tillë është veçse e gjykuar (res judicata).

Sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues, ku thuhet që OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se menaxherin e projektit të cilin e ka prezantuar nuk plotëson kërkesën e FDT-së e cila ka qenë “Menaxheri i projektit të jetë Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë Konstruktiv, me së paku 3 vite përvojë punë pas diplomimit, të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku tri (3) projekte te natyres se njejte (fasadim te objekteve)” me dëshmi dokumentare të kërkuar “per menaxher të projektit; CV, diploma e skanuar nga origjinali, vendimi per caktim te menaxherit, kontrata e punes ose parakontrata per projektin ne fjale dhe letër referencat për së paku 3 projekte të përfunduara”.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson që në kontratën e dorëzuar nga OE i rekomanduar, kontratë kjo e lidhur ndërmjet punëdhënësit “Adi TE Construction” dhe punëmarrësit “Nystret Kastrati” përcaktohet periudha e angazhimit në nenin 6 të saj, ku thuhet që “Punëmarrësi, në punë dhe detyra specifike të përcaktuara sipas nenit 3 të kësaj Kontrate, do të angazhohet prej 04.04.2020 deri me 04.05.2021, përkatësisht 365 ditë”, periudhë kjo e mbulueshmërisë së këtij aktiviteti.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues, ku thuhet se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka prezantuar asnjë kontratë referencë konform kërkesave të FDT-së duke marrë parasysh faktin që një kërkesë e tillë ka qenë “Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së njëjtë (fasadim te objekteve) në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë.”. Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të listës së kontratave dhe dëshmive dokumentare të dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontratë, sqaron se kërkesa e shënuar nga AK në FDT dhe Njoftim për Kontratë ka qenë e specifikuar vetëm në kontrata të fasadim të objekteve. Andaj, Paneli Shqyrtues konsideron se mbetet nën diskrecion të autoritetit kontraktues që të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të LPP-së. Pas përgjigjes ndaj kërkesës për rishqyrtim të AK-së, ku përmendet arsyetimi “*Te përshkrimi teknik-oferta financiare te Kontratat e prezentuara nga OE përmbajnë pozicione me fasadim*” mirëpo nuk përcaktohen pozicionet dhe kontratat në fjalë, Paneli Shqyrtues sqaron se eksperti shqyrtues i ka dërguar email sqarues AK-së, ku ka kërkuar detaje për kontratat mbi të cilat është konstatuar një gjë e tillë. Autoriteti Kontraktues ka dërguar email me dokumente mbështetëse, ku janë të paraqitura pozicione brenda kontratave të dërguara si referencë të cilat përkojnë me fushëveprimin ekzistues të aktivitetit të prokurimit. Si rezultat i sqarimeve shtesë konform dispozitave ligjore në fuqi, autoriteti kontraktues ka ri-vlerësuar tenderin konform nenit 59 të Ekzaminimit, Vlerësimit dhe Krahasimit të Tenderëve.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues pas sqarimeve të pranura ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit dhe nenit 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, ndërsa autoriteti kontraktues në këtë rast ka vepruar konform këtij neni. Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka marr parasysh dhe ka vepruar duke pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentiit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Blerim DINA



#### **Vendimi t'i dorëzohet:**

- 1x1 AK "KK ISTOG";
- 1x1 OE "Loshi Design" – Gurakoc;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.